

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.02.2021*

12.02.2021

Ora 14:35

RENDI I DITËS

Projektakti “Për pranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr.3 , ardhur në KQZ në datën 11.02,2021, subjekti ankues z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

KAS:

Z.Elvin LAKO

Z.Elvis ÇEFA

Z.Illirjan RUSMAJLI

Z.Koli BELE

Z.Ledio BRAHO

Stafi KQZ: Y.Merkaj, Olsi Peto

Parti politike LSI (K.Kolndreu)

Z.K.Bele: Përshëndetje, jemi në verifikimin e elementeve të kërkesës ankimore nr.3 datës 11.02.2021 depozituar pranë KQZ-së orën 15:45 nga ankuesi Erion Veliaj përfaqësuar me prokurën e avokatit Eridian Salianji. Relatimi i kësaj çështje sipas shortit të hedhur nga administrata e KQZ-së gjatë ditës së djeshme do të drejtohet nga relator Koli Bele dhe nga trupa e KAS-it. Presenca e palëve: Kemi palë që janë prezent?

Z.K.Kolndreu, përfaqësues i LSI-së: Po zoti Bele, Kreshnik Kolndreu përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim, prezent. Më falni dua të shtoj diçka zoti Bele,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*

Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.02.2021

jam njoftuar në orën 14:00 për këtë seancë dhe nuk jam njohur me aktet dhe me ankimin. Në këto kushte kërkoj kohë nga ju për t'u përgatitur, faleminderit.

Z.K.Bele: Po është e drejtë kërkesa juaj, besoj jeni në dijeni të afateve të ngushta që ju ka vendosur kodi lidhur me këto lloj gjykimi dhe është një afat rreth 24 orësh nga depozitimi i ankimit. Megjithatë sot jemi në procedurën e verifikimit të elementëve të formës së aktit. Kërkesa do kalojë për gjykim në rastin e një vendimmarrje të tillë, sigurisht që do keni kohën e mjaftueshme. Të mundohemi ta shtyjmë në limitet e kohës që na lejon ligji në mënyrë që dhe ju të jeni pjesë e procesit dhe të bëni mbrojtjen efektive. E njëjta gjë vlen edhe për palët e tjera. Janë bërë njoftimet?

Z.K.Kolndreu, përfaqësues i LSI-së: Dakord!

Z.Y.Merkaj: Po zoti relator, ne komunikam me përfaqësuesin e Kryetarit të Bashkisë, konfirmoi që do të vijë në mbledhje, kështu që nuk e di.

Z.K.Bele: Prezenca nuk përbën shkak për ndërprerjen e procedimit kështu që evidentohet fakti që është njoftuar dhe vazhdon seanca në mungesë të palës ankuese.

Z.Y.Merkaj: Në bazë të nenit 130 i Kodit Zgjedhor kështu që verifikimi paraprak bëhet nga anetarët e KAS-it dhe pastaj nëqoftëse ju e kaloni për shqyrtim ne mund të procedojmë. Ne si administratë kemi arritur në konkluzionin që të tre elementët e nenit 130 përmbushin kriteret, kompetenca e KQZ-së dhe legjitimiteti i ankuesit si dhe respektimin e afateve ligjore të ankimit.

Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.02.2021*

Z.E.Çefa: Me çfarë kam konstatuar nga komunikimi i djeshëm i kërkesës e ankimore besoj që elementët formalë i plotëson, kështu që nuk kemi arsye për të humbur kohë. Caktojmë datën e seancës gjithmonë duke rakorduar edhe me përfaqësuesin e LSI-së që të ketë mundësi të përgatisë edhe ai një material për çështjen.

Z.I.Rusmajli: Sa kohë kemi, sa na lejon ligji?

Z.Y.Merkaj: Deri të martën në orën 14:00.

Z.K.Bele: KAS-i vendosi kalimin e çështjes në shqyrtim. Seanca do të jetë ditën e martë në orën 12:00. Administrata të marrë masat për të njoftuar palët.

Z.I.Rusmajli: Nëqoftëse më lejoni zoti relator një kërkesë për administratën sepse përfaqësuesin e ankuesit nuk e kemi këtu. Në shqyrtim paraprak që i kam bërë unë dokumentacionit më duket që do kishte interes për ne që të administronim edhe të gjitha njoftimet që zyra e shtypit e Bashkisë i ka bërë mediave në këto rastet në fjalë. Mund tja kërkon juve përfaqësuesit të Bashkisë që ditën e martë të na i sjelli maksimalisht ose edhe me parë. Njoftimet përmendin në dokumentacionin e dosjes që zyra e shtypit ka bërë njoftime për mediat në të gjitha këto raste por njoftimet nuk janë administruar. T'i shohim çfarë përmbajtje kanë njoftimet, e para. E dyta, që ndoshta ka interes për të gjithë kolegët, nga aq sa kam parë unë materialet video të Kryetarit të Bashkisë dalin herë pa here referenca për dokumenta pronësie. Për mua është e paqartë çfarë janë këto dokumenta, janë çertifikatë pronësie apo është dokument procedural burokratik paraprak, apo një gjë tjetër. Do të ishte mirë që përfaqësuesi i bashkisë të sillte specifikim të këtyre dokumentave që të kuptonim çfarë janë nëqoftëse ai e ka të qartë se për çfarë bëhet fjalë.

Vendimi nr.5

***Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI***